

MEHMET DERRALLA NUK ËSHTË I YNI ËSHTË I TETOVARËVE

Ardian Skuka

Së pari me lejoni t'ju përshëndes të gjithë Ju tetovarëve,për organizimin e kësaj Akademie përkujtimore , kushtuar Mehmet pashë Derallës e posacërisht z.Arsim Sinani. Jam nipi i Mehmet Derallës, gjegjësisht nana ime e cila ishte e bija, vajza më e vogël e Mehmetit, Nigjari.

Me lejoni t'ju them se Mehmet Deralla është ndër figurat më të rëndësishme të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe në dijet e mija është i përmasave madhore. Dhe kjo nuk është rastësi, por është vazhde e një lufte të pandalshme të familjes Deralla,që fillon qysh me Kurt Derallën, Hasan Derallën, babain e Mehmetit që ishte ndër 9 anëtarët e Komitetit drejtues të Lidhjes së Prizrenit . Nuk është rastësi që Mehmet .Pashë Deralla u zgjodh si përfaqësues i këtyre trevave për në Kuvendin e Vlorës, nuk është rastësi që u bë pjesë e kabinetit qeveritar ashtu sikurse që nuk është rastësi që u zgjodh ministër i luftës me vota pothuaj unanime ,i mbështetur madje me insistim nga tribuni popullor Isë Boletini. Të gjitha këto si rezultat sepse Mehmet Pashë Deralla kishte folur jo me fjalë por me vepra atje ku flasin burrat në fushë të mejdanit. Të gjitha këto kishin ndodhur se Mehmet Pashë Derralla ishte gjenetikusht patriot. Jo me kot Fishta i madh vargëzon tek "Lahuta e malësisë " kënga 9 citoj: "Dhe njaj trim në za Deralla që nuk dinte shumë kopalla por i kishte fjalet e ralla," Natyrshëm Ne, si pasardhës ndjehemi mirë,madje shumë, por as nuk mburremi e nuk mund te mburemi me Te. Ju tetovarët po madje me krenari e zë të lartë krenohuni sepse Mehmet Deralla është i Juaji, është i Tetovës . Padashur të ndikoj tek Ju mund të them pa drojë se Mehmet Pashë Deralla është simbol për Tetovën e simbolet duhet të ruhen, të respektohen e të përcohen tek brezat e rinj sepse popujt që nuk e dinë hitorinë e tyre ka rrezik të shuhen. Edhe njëherë ju pershendes sinqerisht.Qofshi te bekuar

P.s.z.Arsim ! Dëshiroj të jeni mirë familjarisht. Po të dërgoj fjalën time të mbajtur në Tetovë,ashtu sic më keni kërkuar por ndoshta nuk do të mundem të riprodhoj emocionet e asaj dite. Me këtë rast ju falenderoj për ate që keni bërë e keni nisur.